



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Gjuhë e Huaj D Turqisht

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë seminare;
Viti / Semestri : Viti III, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje
Programi i studimit: “Bachelor” – Gjuhë, letersi dhe qytetërim turk
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studenti duhet të ketë njohuri themelore në gjuhën turke. Lënda gjuhë turke si gjuhë e dytë zhvillohet në dy module të vendosura në semestrin e parë dhe semestrin e dytë. Studentët do të punojnë me metodën e nivelit të avancuar, në nivelin B1- B2 të metodës së përzgjedhur për mësim. Do dinë të përdorin aftësitë e të lexuarit kritik në gjuhën e huaj si leximi për të marrë kuptimin, për të nxjerrë konkluzione. Do përdorin strategji komunikimi.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Shkrimi i prezantimeve, organizim i mësimit në gjuhën turke.
- 2.Puna me fjalor të avancuar duke përdorur hamendësimin, nxjerrjen e kuptimit nga konteksti, njohjen e parashtesave dhe prapashtesave.
- 3.Zgjerimin e fjalorit duke përdorur përkufizimin, përdorimin e fjalëve në fjali.

Rezultatet e pritshme :

- 1.Komunikojë dhe shkruajë në mënyrë të saktë dhe të rrjedhshme në gjuhën turke, në nivelin B1–B2, duke përfshirë aftësinë për të përgatitur prezantime dhe për të organizuar ide në mënyrë të qartë.
- 2.Përdorë strategji të avancuara të të lexuarit dhe të të kuptuarit të tekstit, si nxjerrja e kuptimit nga konteksti, analizimi i parashtesave/prapashtesave dhe përdorimi i hamendësimit për të kuptuar fjalë të panjohura.
- 3.Zgjasë dhe pasurojë fjalorin aktiv në gjuhën turke, përmes përkufizimeve, përdorimit të fjalëve në fjali dhe ndërtimit të shprehjeve funksionale për komunikim të përditshëm dhe akademik.